



## Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

### HARTA BUJQËSORE



### Të përgjithshme

**Qarku Vlorës** është një nga rajonet më të mëdha prodhuese të agrumeve në Shqipëri me rreth 68% të prodhimit kombëtar. Vitet e fundit prodhimi i agrumeve është trefishuar në mbi 46.882 tonë (stat.2019), kundrejt 13.336 tonëve që ishin në 2010. **Mandarina** është produkti kryesor në grupin e agrumeve duke zënë rreth 67% të prodhimit kombëtar të tyre. Prodhimi i mandarinës është rritur me shpejtësi në vitet e fundit, si pasojë e prodhimit të mirëorganizuar në ferma dhe kooperativa në Jug, ku përdoret edhe teknologjia e avancuar.



### PRODHIMTARIA E MANDARINËS NË VITE

Në Shqipëri kultivohen rreth 1.5 milion rrënjë agrume, nga ku 83% e tyre janë në prodhim. Peshën kryesore në këtë aktivitet e zë kultivimi i mandarinës. Në qarkun e Vlorës prodhohen rreth 86% të mandarinave në shkallë kombëtare.

Agrume	2010	2015	2017	2019
Gjithsej (000/rrënjë)	763	1,282	1,394	1,521
Në prodhim (000/rrënjë)	530	951	1,109	1,265
Rendimenti (kg/rrënjë)	25,2	31,5	37,0	37,1
Prodhim (000/ton)	13,4	30	41	47

Zona e Konispolit, Xarrës, Finiqit etj. mbulon rreth 80% të prodhimit të mandarinës, me afërsisht 26,000 ton.

Prodhimtaria e agrumeve sipas qarqeve (ton) - 2019						
Nr.	Qarku	Agrume	Portokalle	Limon	Mandarin	Te tjera
1	Berat	1,369	470	158	741	0
2	Dibër	-	-	0	0	0
3	Durrës	1,471	662	414	395	0
4	Elbasan	2,403	1,549	470	372	12
5	Fier	7,546	4,051	1,534	1,961	0
6	Gjirokastrë	26	22	3	2	0
7	Korçë	-	-	0	0	0
8	Kukës	-	-	0	0	0
9	Lezhë	472	232	49	189	2
10	Shkodër	386	80	25	281	0
11	Tiranë	1,434	560	348	526	0
12	Vlorë	31,774	3,931	1,073	26,768	2
Gjithëj / Total		46,882	11,556	4,075	31,235	16

Sezoni i vjeljes së mandarinës fillon në 10 ditëshin e fundit të muajit Tetor dhe vazhdon deri në fillim të muajit Shkurt.

Në vazhdim në pemëtore kryhen punimet e tokës (frezim, prerje bari), krasitje, spërkatjet në faza të ndryshme, që shkojnë deri në 30 spërkatje, shoqëruar me plehrimet me kristalore, gjethore, fungicite, insekticide, etj.

Ujitja fillon zakonisht në muajin maj dhe vazhdon deri në muajin shtator, dhe më intensivisht gjatë periudhës së nxehtë të verës. Shpenzimet vjetore në një pemëtore me teknologji të lartë shkojnë deri në 1,300,000 lekë/ha.

## CMIMET E TREGUT DHE IMPORTI I MANDARINËS

Në shkallë kombëtare, në 10 vitet e fundit, kemi një dyfishim të mbjelljes dhe prodhimit të agrumeve, ku spikat vecanërisht kultivimi i mandarinës.



### REKOMANDIME

Eksport Mandarine 2019-2020				
Emërtimi	Sasia/ton		Vlera/mln lekë	
	2019	2020	2019	2020
Satsumas	459.61	293.98	30.75	18.69
Clementines	1,126.75	780.42	79.71	39.39
Te tjera	11,972.27	11,088.74	417.76	343.10
<b>Total</b>	<b>13,558.63</b>	<b>12,163.14</b>	<b>528.24</b>	<b>401.18</b>

Import Mandarine 2019-2020				
Emërtimi	Sasia/ton		Vlera /mln lekë	
	2019	2020	2019	2020
Satsumas	431.0	827.8	29.1	53.4
Clementines	1,750.2	616.5	92.4	32.7
Te tjera	68.5	579.9	3.6	33.0
<b>Total</b>	<b>2,249.7</b>	<b>2,024.1</b>	<b>125.1</b>	<b>119.1</b>

> Në zonën e Xarrës dhe Konsipolit operojnë 7 pika grumbullimi, nga ku vetëm 2-3 pika janë gjysëm të specializuara për trajtimin e plotë të agrumeve.

Struktura e sipërfaqeve me mandarina ne Xarre&Konsipol			
Mandarina sipas hershmerise	Varietetet	Periudha vjeljes	Struktura (ha)
Te hershme	Oronules	20 Tetor - 5 Nentor	15
Sezoni	Clementina	5 Nentor - 15 Dhjetor	830
Te vonshme	Nova	1 Janar - 30 Janar	50
Shume te vonshme	Ortanic	10 Shkurt - 30 Mars	5

> Cmimet e shitjes së mandarinës variojnë sipas varieteteve dhe cilësisë së tyre.

Cmimet e shitjes se manadarines ne ferme			
Produkti	Periudha	Cmimi/lek	Sasia ne %
Mandarine (Oronules)	20 Tetor - 1 Nentor	80	2
Mandarine (Clementina)	1 Nentor - 20 Nentor	40	30
Mandarine (Clementina)	20 Nentor - 15 Dhjetor	30	40
Mandarine (Clementina)	15 Dhjetor -10 Janar	20	22
Mandarine (Nova)	10 Janar - 10 Shkurt	40	5
Mandarine (Ortanic)	10 Shkurt - 28 Shkurt	50	1

> Situata e tregimit të mandarinës rezulton e ulët. Krahasuar me vitet e mëparshme rezulton një rënie në plotësimin e kërkesës, me afërsisht 60%, për arsye të dëmit të shkaktuar nga breshëri në muajin Shtator. Kjo ndikoi në uljen e cilësisë e cila u shoqërua me një rënie të ndjeshme të cmimit të mandarinës.

> Pavarësisht dëmeve nga faktorët klimaterike, eksportet e mandarinës nuk rezultuan me rënie të ndjeshme në volume, gjë që nuk u ndikua as me rritje të importeve. Kjo situatë ndikoi vetëm në uljen e fitimit të parashikuar në fermë, me rreth 60-70%.

Të gjitha investimet e prezantuara mbështeten lehtësisht nga programi i granteve IPARD dhe fondi i garancisë së BERZH-it dhe Qeverisë Shqiptare-AASF. Financimi i investimeve mund të përfshihet nën programin AASF, duke i ofruar kështu mundësinë bizneseve të përfitojnë nga kushtet lehtësuese të ofruara nga Institucionet Financiare Partnere të programit: ProCredit Bank, IntesaSanpaolo Bank, OTP Bank, Raiffeisen Bank dhe Fondi Besa.

Kontakte:

Adela Leka, Drejtuese e Projektit AASF: [adela.leka@asf.com.al](mailto:adela.leka@asf.com.al)

Ilir Pilku, Ekspert i Lartë i Agrobiznesit pranë AASF: [ilir.pilku@asf.com.al](mailto:ilir.pilku@asf.com.al)

Për më shumë informacion: <http://www.asf.com.al>

✓ Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të agrumeve kërkon përmirësime në strukturën e kultivarëve duke e shtrirë më shumë periudhën e vjeljes dhe ekzistencës së produktit në treg, shtimin e sipërfaqeve me mbjellje të reja, duke përfshirë këtu varietetet që kërkohen më tepër nga tregu, duke përdorur teknologji shumë intensive e cila përbën një mundësi për investime.

✓ Rritje te kapaciteteve të ruajtjes në kushte frigoriferike dhe instalimit të linjave të specializuara që kryejnë pastrimin, selektimin, parafinimin dhe ambalazhimin e mandarinës.

✓ Rritje të prodhimit të agrumeve si domosdoshmëri jo vetëm për uljen e importeve, por edhe për ti shërbyer industrisë së përpunimit të lengjeve dhe vecanërisht në ngritjen e industrisë së prodhimit të koncentratit për industrinë ushqimore. Shqipëria për plotësimin e nevojave të industrisë përpunuese me koncentrat frutash importon rreth 250 tonë koncentrat në vit.

✓ Manaxhimi i humbjeve në aktivitetin e pentarisë dhe agrumishteve në vecanti nëpërmjet investimeve në rrjetat antibreshër është një domosdoshmëri absolute. Gjatë vitit 2020 dëmtimi nga breshëri kaloi në 2 faza: 40% e prodhimit u dëmtua menjëherë nga breshëri dhe 20% u kalbëzua në një periudhë 3-4 javore.

✓ Investimet në mekanikë bujqësore të specializuar, traktorë “kategoria III-B” në përputhshmëri me kërkesat e IPARD-it, apo agregate bujqësore profesionale tashmë janë një domosdoshmëri në rritjen e efikasitetit të fermës.

✓ Mbajtja e shënimeve financiare dhe agroteknike në fermë është një kërkesë e kohës për dy arsye kryesore:

- Certifikimin Global Gap,
- Kreditimin nga sistemi bankar.